



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.868/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Shqipe Fazliu - Deliu nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Fushë Kosovës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. Pranohet** si i bazuar apeli Anr.868/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, Shqipe Fazliu - Deliu nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Fushë Kosovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 0906E/01D, 0907E/01R, 0911E/01D.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës, në Komunën e Fushë Kosovës, në Vendvotimet 0906E/01D, 0907E/01R, 0911E/01D.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.884/2021 të paraqitur nga Shqipe Fazliu - Deliu nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Fushë Kosovës, me të cilën pretendon se në vendvotimet 0906E/01D, 0907E/01R, 0911E/01D. Ka ndërhyrje në formular, ku nuk më janë numëruar 10 vota, pasi që në formular shihet se mbi numrin 10 është shënuar numri 1.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Politik Partia Demokratike e Kosovës Shqipe Fazliu - Deliu, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartcekur, PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekur është i bazuar .

Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, ku shihet qarte se nga formularët e bashkangjitur me apel rezulton fakti se ka ndërhyrje në formular, gjë që procesin e bartjes së votave gjatë numërimit në formularë në vendvotimet e lartcekura e bënë të pa rregullt.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 868/2021 më datën 06.11.2021.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.